



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr. 03.123

15.04.2022

Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 55 paragrafët 5, 6, dhe 7 nga i njëjti Ligj, pika 6 i Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/10 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi si në vijim:

Vendim
për marrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) 24 VESTI SHPKNJP Shtip, për shkelje të nenit 55 paragrafët 5, 6 dhe 7 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, ku në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, nga 4 marsi 2022 është transmetuar emision dokumentar-argëtues „1001 racione“ i cila nuk është shënuar si emision në të cilën vendosen produkte,ndërsa produktet e vendosura nga sponsorë të caktuar, në mënyrë të veçantë promovohen përmes theksimit të tepërt vizual dhe verbal.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022,e cila është pjesë përbërse e Vendimit si Shtojcë nr.1.

2.DETYROHET SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

3.Pas përfundimit të afatit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet kontroll mbikëqyrës, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

4.Ky vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratim të tij do të konsiderohet data e verifikimit të tij në arkivin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjenci) bazur në nenin 28 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), është kompetente për kryerjen e mbikëqyrjes programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve programore audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë

operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik duke respektuar dispozitat nga Ligji i cituar, lejet, vërtetimet e dhëna për regjistrim, akte nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmori masë – vendim për paralajmërim publik në pajtim me Ligjin, në rastet kur kemi shkelje të dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara me të njëjtën bazë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Neni 55 paragrafët 5, 6 dhe 7 nga LSHMAAV parashohin se programet që përmbajnë vendosje të produktit duhet qartë të theksojnë se kemi të bëjmë me produkte programore të vendosura. Këto produkte duhet të shënohen siç duhet në fillim dhe në fund të programit dhe gjatë programit në vazhdim në çdo reprizë reklamuese, për të shmangur konfuzionin tek shikuesi (paragrafi 5). Programet që përmbajnë vendosje të produkteve nuk duhet të nxisin drejtpërdrejt blerjen ose marrje me qira të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht përmes rekomandimeve të tyre të veçanta promovuese (paragrafi 6). Në programet që përmbajnë vendosje të produkteve nuk duhet t'i kushtohet rëndësi e tepruar (theksim i veçantë ose referencë) për produktin në fjalë (paragrafi 7).

Në kuadër të kompetencave Ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 24 mars 2022, ka kryer një mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) ndaj shërbimit programor televiziv SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip, transmetuar më 4 mars 2022, në nivel shtetëror, ku konstatoi shkelje të nenit 55 paragrafët 5, 6 dhe 7 nga LSHMAAV.

Shkelja është kryer në emisionin dokumentar-argëtues „1001 racione“, e transmetuar më 4 mars 2022., e cila nuk ka shënuar në program për vendosjen e produkteve, edhe pse produkte nga sponsorë të ndryshëm janë direkt të përfshirë në veprim/skenarin e emisionit dhe veçanërisht të promovimit rekomandues përmes mjeteve vizuale dhe verbale me mbitheks të veçantë. Në fakt, emisioni dokumentar-argëtues 1001racione“ është program TV nga fusha e kuzhinës(gatimit), ku shumica e produkteve të sponsorëve janë të përfshirë drejtpërdrejt – të vendosur – në veprim/skenarin e emisionit, por emisioni përsëri nuk është grafik e përshtatshme si një “program në të cilin janë vendosur produkte”.

Shkelja e paragrafit 1 nga po e njëjta pikë, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022, e cila është pjesë plotësuese e këtij Vendimi si Shtojcë nr.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip më 25.03.2022, dërgoi shkresë – Dorëzim të Raportit me shkrim nga mbikëqyrja për shpjegim ark.nr.10-1210/2 nga 25.03.2022, dhe dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022, ku në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkelje të dispozitave nga LSHMAAV. Në afatin e përcaktuar, SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip nuk u deklarua për shkeljen e dispozitave nga Ligji. Këshilli i Agjencisë në sencën e mbajtur më 15.04.2022, e shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip për shqiptim të masës – paralajmërim publik.

Në vijim të sa më sipër u përmend, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20, neni 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 55 paragrafët 5, 6 dhe 7 nga i njëjti Ligj, pika 6 i Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/10 nga 15.04.2022, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022, miratoi Vendim ku paralajmërohet publikisht SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip dhe detyrohet në afat kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtueshmëri me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe ndaj tij radiodifuzeri ka të drejtë padie për kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ duhet të paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa u paraqit më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Në kundërshtim me vendimin radiodifuzeri mund të ngrejë padi për kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1210/1 nga 25.03.2022.

Dorëzuar tek:

- SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip;
- Administratorit të SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip;
- Personi përgjegjës i programit në SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip;
- Sektori për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektori për çështje programore dhe
- Personat e autorizuar në Agjenci për udhëheqjen e regjistrimit Up1.